

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TRYANDONE TECH” SHPK

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011 vendoset si me poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot më datë 25.04.2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “TRYANDONE TECH”shpk

Themeluesit e shoqërisë TRYANDONE TECH Shpk janë;

Z. Erald Oka, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 09.02.2002, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.036033241 dhe nr.personal: K20209073V, i cili redaktoi këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

“Aktivitet në fushën e teknologjisë së informacionit, programim kompjuterik dhe elektronik, online marketing, menaxhimi i rrjeteve dhe faqeve kompjuterike. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.”

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Ruga: Fran Ivanaj; Nd.11; H.2, Paskuqan; Kamëz, Shqipëri.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 400.000 (katërqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:



Lloji i kontributit është në para në vlerën 400.000 (katëëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë si më poshtë;

- **Z. Erald Oka**, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar teresisht nga ortaku i shoqërisë.

Kreu III
Administratori i shoqërisë.

Neni 6
Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Erald Oka, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 09.02.2002, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.036033241 dhe nr.personal: K20209073V me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit tregtar.

Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Ky akt themelimi është përpiluar në dy kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.

Tiranë, më datë 25.04.2024.

ORTAKU THEMELUES

ERALD OKA

Erald Oka

